

Viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, e shfrytëzimit ose e një aksidenti në vendin e punës

Si mund të kërkoj
dëmshpërblim?



FEDERAL PUBLIC SERVICE
JUSTICE

.be

Përmbajtja

Viktima e trafikimit të qenieve njerëzore: Si të kërkonti kompensim	4
Cilat shërbime mund të më vijnë në ndihmë?	4
Procedura e kërkesës së dëmshpërblimit	5
Hapat që duhet të ndërmar	6
Organet që mund të më vijnë në ndihmë	8
Viktimë e shfrytëzimit: rikuperim i pagave të prapambetura dhe i të drejtave të tjera shoqërore	11
Viktimë e një aksidenti në vendin e punës: si të bëni një deklaratë	14
Kontaktoni	15

Jeni viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, e shfrytëzimit ose i një aksidenti në vendin e punës?

Mund të bëni përçapje për të kërkuar **pagesën e dëmshpërblimit**, të rikuperoni **pagat e prapambetura** ose **të deklaroni** një aksident në vendin e punës. Nuk keni pse i kryeni vetëm këto përçapje. Ekzistojnë organizma që do t'ju vijjnë në ndihmë.

Në këtë broshurë, do të zbuloni cilat **organizma ndihmëse specifike** mund **t'ju shoqërojnë** në cilësinë e viktimës.

Kujdes: mbani mend **se jeni ju që zgjidhni gjithmonë përçapjet** që ndërmerrni si viktimë dhe se të gjitha rrugët kanë **të mirat dhe të këqijat e tyre**. **Nuk ka garanci** se do të merrni dëmshpërblimin që dëshironi.



Viktme e trafikimit të qenieve njerëzore: si mund të kërkoj dëmshpërblim?

Cilat shërbime mund të më vijnë në ndihmë?

Nëse jeni **viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore**, shoqëruesi juaj mund të jetë një qendër e specializuar si **PAYOKE, PAG-ASA** ose **SÛRYA**. Këto qendra japin mbështetje psikosociale, **mjekësore dhe juridiko-administrative**, ju informojnë për **të drejtat tuaja si viktimë** dhe ju shpjegojnë si të kërkon **shpërblimin** e dëmit tuaj ose si të kërkon **ndihmën e një avokati**.

Për ta përfituar këtë shoqërim, ju duhet **të përmbushni** një numër të caktuar **kushtesh ligjore** (konkretisht që jeni i gatshëm të bëni një kallëzim ose të bëni një deklaratë, të ndërpritni kontaktet me autorin etj.).

Konsultoni faqet e internetit të qendrave PAYOKE, PAG-ASA ose **SÛRYA websites** për të marrë më shumë informacion për këto kushte.

Nuk mund ta përfitoni shoqërimin në rast se:

- **nuk jeni gati** t'u përgjigjeni kushteve të vëna me ligj;
- jeni **kthyer në vendin tuaj të origjinës**;
- **nuk ka trafikim të qenieve njerëzore**.

Megjithatë, në këto raste, këto qendra mund t'ju informojnë dhe t'ju orientojnë drejt:

- një **zyre të ndihmës juridike (ZNJ)** për të marrë **një avokat të ndihmës juridike falas** (d.m.th. i paguar nga shteti);
- **Agjencisë federale për rreziqet profesionale (FEDRIS)** për të deklaruar **një aksident në vendin e punës**;

- › **FAIRWORK Belgium** për pyetjet rreth të drejtave tuaja në fushën e punës (nëse punoni në Belgjikë duke qëndruar në mënyrë të paligjshme ose nëse keni të drejtë qëndrimi të kufizuar).

Procedura e kërkesës së dëmshpërblimit

Në cilësinë e **viktimit të trafikimit të qenieve njerëzore**, mund të kërkonit pagesën e dëmit tuaj nëpërmjet:

- › **një procedim penal** kundër autorit (pas depozitimit të kallëzimit në polici ose te shërbimi i inspektimit social dhe nëse ky i fundit i ka dhënë rrugë përndjekjes së autorit);
- › **një procedurë civile** (e cila është e mundur vetëm pas procedimit penal);
- › një **fondi të posaçëm (Komisioni për ndihmën financiare për viktimat e akteve të qëllimshme të dhunës)**.



MASSAGE

Hapat që duhet të ndërmarr

Kjo skemë ju jep një ide të ecurisë që mund të ndjekë **një procedim penal kundër autorit:**

01

Depozitimi i kallëzimit
ose bërja e deklaratës

02

Hapja e një hetimi penal

03

Vendim i formës së prerë dhënë me një
vendim dënues nga gjykata: dënim
i autorit dhe dhënie e dëmshpërblimit

04

Përçapjet për të marrë pagesën efektive
të dëmit

1. Depozitimi i kallëzimit ose bërja e deklaratës

Që të mund të hapet një hetim (penal), duhet që fillimisht ju të bëni **një deklaratë ose të depozitoni një kallëzim** në **polici** ose në **shërbimin e inspektimit social**.

Kujdes: Vetëm duke bërë deklarin si person i dëmtuar mund të ndiqni trajtimin e kallëzimit tuaj. Mund ta depozitoni deklaratën si person i dëmtuar gjatë marrjes në pyetje në polici ose në shërbimin e inspektoratit social, por mund ta depozitoni vetë më vonë ose ta dërgoni të nënshkruar në sekretariatit e prokurorisë, **ose t'i kërkonti avokatit tuaj ta bëjë.**



E dorëzoni vetë kallëzimin ose deklaratën tuaj në polici ose te inspektorati? Atëherë, **Shërbimi i Ndhmës për Viktimat ose Centrum Algemeen Welzijnswerk (CAW)** mund t'ju shoqërojë dhe t'ju japë **mbështetje** administrative dhe emocionale.

2. Të kërkosht dëmshpërblim

Pas depozitimit të kallëzimit ose të deklaratës, prokuroria vendos nëse ka **prova** të mjaftueshme për ta çuar çështjen tuaj para **gjykatës**.

Nëse ndodh kështu, mund t'i kërkonti **gjyqtarit shpërblimin e dëmit që keni pësuar**.

Kujdes: e dëshironi dëmshpërblimin **pas dënimit të autorit**? Kjo është e mundur nëpërmjet **një procedure civile**.

Organet që mund të më vijnë në ndihmë

Sa i takon procedurës penale, mund t'i kërkonti ndihmë:

› **Ndihma juridike parësore:**

Ajo jep **falas një këshillim të parë juridik** të orientuar në rast se dëshironi të kërkonti dëmshpërblim, komunikon informacione praktike, ju orienton drejt shërbimeve të tjera dhe u përgjigjet pyetjeve të thjeshta juridike.

› **një avokati:**

Këshillohet të kontaktoni një avokat, sepse ai mund t'ju japë **një opinion të detajuar dhe të orientuar** nëse doni të kërkonti dëmshpërblim. **Ndihma juridike dytësore (BAJ)**, kryesisht në funksion të të ardhurave tuaja, mundet t'u drejtohet shërbimeve **falas ose me tarifë të reduktuar të një avokati**.



- **Komisioni për ndihmën financiare për viktimat e akteve të qëllimshme të dhunës:** Kjo organizatë jep **ndihmë financiare** në rast se:
 - jeni viktimë e një **akti dhune të qëllimshëm** të kryer **në Belgjikë**;
 - keni pësuar **dëm fizik ose psikik të rëndësishëm** si rezultat i këtij akti;
 - dhe kur të gjitha **mënyrat e tjera** për të marrë dëmshpërblimin **nuk janë përfunduar**.

Kujdes: Mund edhe të dorëzoni një kërkesë para Komisionit nëse largoheni nga Belgjika dhe keni ende një **adresë postare në Belgjikë**.



Viktimë e shfrytëzimit: rikuperim i pagave të prapambetura dhe i të drejtave të tjera shoqërore

Nëse jeni viktimë e shfrytëzimit, ju mund të përpiqeni të rikuperoni **pagat e prapambetura dhe të drejtat e tjera shoqërore** (për shembull: pagesat e pushimeve ose shpërblimin në fund të vitit).

Mënyra më e shpejtë për të rikuperuar pagat e prapambetura është të arrini **në një marrëveshje me punëdhënësin tuaj për këtë çështje**. Në këtë aspekt, mund të kërkonit ndihmë:

- › te **sindikata** në të cilën jeni anëtarësuar;
- › një **avokati**;
- › te **FAIRWORK Belgium**.

Nuk keni arritur një marrëveshje me punëdhënësin tuaj?

Atëherë mund të përpiqeni të merrni pagat e prapambetura ose të drejtat e tjera shoqërore:

- › duke bërë **një deklaratë tek the Shërbimi i Mbikëqyrjes së Kontrollit të Ligjeve Sociale (CLS)**;
- › ose duke **nisur një procedurë para gjykatës së punës**. Në këtë rast, rekomandohet të kërkonit ndihmën e një avokati.

Në bazën e provave që do të sillni, Shërbimi i CLS mund të përpiqet të bindë punëdhënësin tuaj të paguajë pagat tuaja të prapambetura.

Shërbimi CLS nuk arrin ta bindë punëdhënësin tuaj?

Në këtë rast, shërbimi CLS mund **ta dërgojë çështjen tuaj tek inspektorati i punës**. Atëherë, inspektorati i punës mund të vendosë të **përndjekë** punëdhënësin tuaj. Në këtë rast, është i mundur rimbursimi i pagave tuaja të prapambetura nga punëdhënësi juaj edhe nëse ju jeni kthyer tashmë në vendin tuaj të origjinës.

Kujdes: për të bërë këtë gjë, ju duhet të **depozitoni një deklaratë si person i dëmtuar.**

Në rast se pagesa nuk kryhet menjëherë (për shembull për shkak të mungesës së informacioneve), shuma që ju detyrohen do të derdhet në **Caisse des Dépôts et Consignations**. Në këtë rast, merrni kontakt me **Caisse des Dépôts et Consignations** për të kërkuar shumën (shih "Kontakte").

Mbani parasysh elementet e mëposhtme:

- › Në rast se gjyqtari merr kërkesën për zhdëmtimin e dëmit tuaj, ju mund të përpiqeni të merrni këtë dëmshpërblim nga **shumat e parave që mund t'i jenë sekuestruar dhe konfiskuar** të dënuarit që ju detyrohet këto shuma parash. Avokati juaj mund t'i kërkojë Organit qendror për Sekuestrimin dhe Konfiskimin (OCSC) të çlirojë shumat e alokuara.
- › **Nuk ka garanci për rimbursimin** në rast se i dënuari nuk ka **mjete financiare të mjaftueshme.**
- › **Ju e paguani vetë avokatin tuaj** në rast se **nuk përmbushni kushtet** për të marrë avokat falas.
- › Në rast se punëdhënësi juaj falimenton, duhet të **paraqitni** kërkesën e kreditorit para shërbimit kompetent (administratori i falimentimit) në **kohë**. Mund edhe ta paraqitni kërkesën në internet nëpërmjet: www.regsol.be.
- › Procedurat mund të jenë **të gjata**.

Kujdes: nëse nuk banoni më në Belgjikë, kontaktoni avokatin tuaj, qendrën e specializuar ose një shërbim tjetër i cili ju ka mbështetur gjatë çështjes suaj në Belgjikë.



Viktimë e një aksidenti në vendin e punës: si të bëni një deklaratë?

Në rast se jeni viktimë e një aksidenti në vendin e punës, mund ta bëni deklaratën tuaj nëpërmjet **sigurimit të aksidenteve në punë të punëdhënësit tuaj**.

Nëse ai nuk ka **kontratë sigurimi për aksidentet në punë**, kontaktoni:

- **Sindikatën** tuaj;
- **FAIRWORK Belgium**;
- ose një **avokat**.

Nëpërmjet njërës prej këtyre instancave, keni mundësinë të depozitoni një **deklaratë** në **Agjencinë federale për rreziqet profesionale (FEDRIS)**.

Kujdes: duhet ta depozitoni deklaratën tuaj brenda një afati prej **tre vitesh** pas aksidentit në vendin e punës.

Në funksion të seriozitetit të aksidentit tuaj në vendin e punës dhe të përgjegjësisë së punëdhënësit tuaj në këtë aksident, ka mundësi që prokuroria ose inspektorati i punës të hapë një **hetim**. Në rast se aksidenti në vendin e punës njihet si i tillë, **duhet të ndërhyjë sigurimi për aksidentet në punë ose FEDRIS për:**

- shpenzimet mjekësore;
- për paaftësinë e përhershme ose të përkohshme në punë.



Kontaktet

- › Qendrat e specializuara për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore
 - › **PAYOKE** (Flanders)
 - T 03 201 16 90
 - E admin@payoke.be
 - www.payoke.be
 - › **PAG-ASA** (Brussels)
 - T 02 511 64 64
 - E info@pag-asa.be
 - www.pag-asa.be
 - › **SÜRYA** (Wallonia)
 - T 04 232 40 30
 - E info@asblsurya.be
 - www.asblsurya.org/fr/contact
- › **Agjencia federale për rreziqet profesionale (FEDRIS)**
 - www.fedris.be/fr/contact
- › **FAIRWORK Belgium**
 - T 0800 12019 (të hënën dhe të mërkurën ora 9:00 - 13:00 dhe të enjten ora 13:00 - 16:00)
 - E info@fairworkbelgium.be
 - www.fairworkbelgium.be/fr



› **Zyra e Ndhmës Juridike (BAJ)**

(avokat falas)

› **Wallonia**

- › www.avocats.be/fr > komisionet e ndihmës juridike

› **Bruksel**

- › FR www.bajbruxelles.be/index.php/fr
T 02 511 50 45
E bjb@baliebrussel.be
- › NL www.baliebrussel.be

› **Flandër**

- › www.vlaanderen.be > Conflicten en misdrijven > Commissies voor juridische bijstand
- › www.prodeoadvocaat.vlaanderen > Contact > Bureau juridische bijstand

- › **Service Aide aux Victimes**
(Shërbimi për Mbështetjen e Viktimave)
www.victim.es.cfwb.be/ou-trouver-aide

- › **Centrum Algemeen Welzijnswerk (CAW)**
www.caw.be

- › **Caisse des Dépôts et Consignations**
T 02 572 57 57
E info.cdcck@minfin.fed.be
www.finances.belgium.be/fr > FAQ > Caisse des
Dépôts et Consignations : généralités > 'Quelle est la
meilleure manière de contacter la Caisse des Dépôts
et Consignations ?'

- › **Contrôle des lois sociales (CLS)**
(Kontrolli i ligjeve sociale)
T 02 235 55 55
E (FR) info.cls@emploi.belgique.be
E (NL) info.tsw@werk.belgie.be
E (DE) info.cls@beschaeftigung.belgien.be
T (FR/DE) 02 235 55 60

<https://emploi.belgique.be/fr> > A propos du SPF >
Structure du SPF > Inspection du travail – Direction
générale Contrôle des lois sociales > Directions
externes

Keni ende pyetje? Në këto broshura dhe faqe interneti do të gjeni më shumë informacion

- › Broshura 'Vous êtes victime' (Ti je viktimë)
<https://justice.belgium.be/fr> > Publications > Brochures pour le citoyen > Vous êtes victime.
- › Faqja e internetit 'Que faire comme victime' (Çfarë duhet të bëni si viktimë)
<https://justice.belgium.be/fr> > Thèmes et dossiers > Que faire comme > Victime.
- › Broshura 'Vos droits en tant que victime d'infractions' (Të drejtat tuaja si viktimë e krimeve)
<https://www.tribunaux-rechtbanken.be/fr> > Info utiles > Brochures > Vos droits en tant que victime d'une infraction.
- › Faqja e internetit 'Informations sur le déroulement de la procédure en tant que victime' (Informacion mbi procedurën si viktimë)
<https://justice.belgium.be/fr> > Thèmes et dossiers > Que faire comme > Victime > Procédure > Déroulement de la procédure.
- › Faqja e internetit 'Informations pour les victimes d'actes intentionnels de violence' (Informacion për viktimat e akteve të qëllimshme të dhunës)
<https://justice.belgium.be/fr> > Thèmes et dossiers > Que faire comme > Victime > Aide financière > Victimes d'actes intentionnels de violence.



Shërbimi i Komunikimit dhe Informacionit
Boulevard de Waterloo 115
1000 Bruxelles
T 02 542 65 11
www.justice.belgium.be